



Prishtinë, 11 nëntor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_859\_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafet 1.11 dhe 1.12, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike të dorëzuar në ZRRE me datë 09.12.2015 nga ndërmarrja "GSA ENERGJI" SH.P.K (në vijim GSA), adresa: Rr. Xheladin Hana, Obj.35/15, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2016, nxori këtë:

#### VENDIM

- I. **LËSHOHET** Licenca për furnizim me energji elektrike ndërmarrjes "GSA ENERGJI" SH.P.K me numër licence ZRRE/Li\_48/15 për periudhën nga data **11 nëntor 2016 deri 10 nëntor 2021**.

#### Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09.12.2015 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë nga ndërmarrja "GSA ENERGJI" SH.P.K.
- o ZRRE ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të ZRRE-së dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike.
- o Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në ZRRE duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në ZRRE për Licencë të Furnizimit me energji elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij.



- Ndërmarrja GSA me datë 11 janar 2016 ka publikuar Njoftimin në gazetë, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur.
- ZRRE pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmime tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes GSA, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- ZRRE, në përputhje me Rregullin për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar. Në rastin konkret ZRRE nuk ka mundur të veproj sipas afateve të përcaktuara me Rregullën për Licencim si rezultat i mungesës së këtyre rregullave: Metodologjisë për llogaritjen e çmimit të jo-balancës dhe çmimit të Kompensimit si dhe Rregullës për ndërrimin e Furnizuesit, që janë të domosdoshme për funksionimin normal të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike. Tanimë këto rregulla janë hartuar, finalizuar dhe aprovuar nga ZRRE.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.


III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit "GSA ENERGJI" SH.P.K dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, U.D. kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Seffijaj, anëtar